

STATUTI

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "P&B VISION" SH.P.K

Sot më datë 12 Dhjetor 2019, duke u bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit" i ndryshuar, ne të nënshkruarit shprehim vullnetin tonë të lirë dhe të plotë, për të nënshkruar këtë statut me qëllim krijimin e shoqërisë "P&B VISION" sh.p.k.- si më poshtë vijon:

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

NENI 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1.1 Sot, në datë 12 Dhjetor 2019, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "P&B VISION" SH.P.K

1.2 Themeluesit i shoqërisë është **Z. GAZMIR PORJA**, i datëlindjes 19.11.1972, lindur në qytetin Burrelit, dhe banues në Burrel, shtetas Shqiptar, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtës i leter njoftimit me nr. J21119031A;

1.3 Themeluesit i shoqërisë është **ZNJ. MIRELA BRAHASANI**, e datëlindjes 16.03.1976, lindur në qytetin Burrelit, dhe banues në Burrel, shtetase Shqiptar, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtës e pasaportes me nr personal. H65316189J;

I cilët ka vendosur krijimin e shoqërisë dhe miratimin e statudit të shoqërisë në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë veçanërisht sipas Ligjit 9901 dt 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe si person juridik të zhvillojnë aktivitetin në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe me normat e këtij statuti. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 2

Objekti

2.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: **Shoqëria do të kryejë çdo lloj aktiviteti që lejohet nga legjislacioni Shqiptar në Fuqi, Kryesisht, Import-eksport dhe shitje-blerje me shumicë dhe pakice të hidrosanitare, hidraulike, duraluminit, pllakave të gjithave llojeve, material të nderti, material elektrike, duraluminit, pllakave të gjithave llojeve, plastikes, gomes, bimeve mjekesore, lendes drusore e mobiljeve të linjave të prodhimit e perpunimit, konfeksioneve, por pa u kufizuar veten në keto, Veprimtari në fushen e ndertimit, prodhimi dhe tregtimi i materialeve të ndertimit, import eksporti i tyre brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë shoqërisë dhe të tjetër. Veprimtari në fushen e turizmit, me qëllim jo vetëm ngritjen por shfrytëzimin dhe zhvillimin e veprimtarive në fushen e hotelerisë, fshatrave turistike të pushimit, qendrave të argetimit, brenda dhe vendit, si dhe të blejë, të marrë dhe të japë me qera, të ndertojë apo të nxisë ndertimin e tyre, duke vepruar në këto fushe apo me partnere të tjerë. Barrestorant, veprimtari në fushen e argetimit, si salla pingpongu, bilardoje dhe lojra të tjera argetuese. Vendosja në dispozicion të klienteles, ambiente të pershtatshme për të prezantuar mallrat tregtareve, mediatoreve dhe biznesmeneve të interesuar për shitblerjen e mallrave të ndryshëm. Të shërbejë si perfaqësuese shitjeje e marketingu, agjent shitje për shoqëri vendase dhe të huaja, të angazhohet në shitje me shumicë dhe pakice dhe të hapë dyqane për këto qëllim, dege apo zyra po të jete e**

nevojshme per arritjen e qellimit te shoqerise. Shoqeria mund te beje ose mund te kerkoje regjistrimin ne emer te saj, transferoje apo te tregtoje si te njejta, patenta e te drejta autori, marka te ndryshme, marketingu, licensa, tituj tregtie si dhe te drejta te ngjashme intelektuale dhe industriale.

NENI 3

Kohëzgjatja

- 3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakëve të shoqërisë.

NENI 4

Selia

- 4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Burrel – Peshkopi" Km 1, Ndertes Private, Zona Kadastrale Nr.1325, Nr Pasurie 414/14
- 4.2 Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon :
e-mail: emigjen@gmail.com
Nr.Cel: 0672519255

KREU II

Neni 5

Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (Njeqind mijë) Lekë, e perbere nga 2 kuota me vlere 50.000 lek secila, tërësisht i shlyer nga ortakët përpara regjistrimit te shoqërisë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
1. Ortaku themelues : **Gazmir Parja** Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)
 2. Ortaku themelues : **Mirela Brahasani** Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

NENI 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar dhe licensuar per keto kontribute me vendim asambleje të shoqërisë sipas kërkesës së administratorit.
- 6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit , vendimet merren me 4/5e zotëruesve të kuotave të kapitalit të shoqërisë.
- 6.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

- 7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, ndërsa për persona të tjerë jashtë shoqërisë do të funksionojë e drejta e parablerjes, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- 7.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

- 8.1 Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 8.2 Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 8.3 Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorit/ëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit/ëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 8.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 8.6 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

- 9.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 9.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10
Kuorumi

- 10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë 4/5 e zotëruesve të kuotave të kapitalit të shoqërisë.
- 10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse janë të pranishëm ortakët që zotërojnë të paktën 4/5 e kuotave të kapitalit të shoqërisë, të cilët votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11
Marrja e vendimeve

- 11.1 Asambleja e përgjithshme vendos me katër të pestat (4/5) e votave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë edhe për çështje të tjera si :
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ëve;
 - c) emërimin e shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim i statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12
Përgjithshmi nga e drejta e votës

- 12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 12.1 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13
Administrimi

- 13.1 Asambleja e përgjithshme emëron me 4/5 e votave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë, një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
- 13.2 Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhona efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.



- 13.3 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 13.4 Personime të dhënat si më poshtë vijon caktohet si Administratorë i shoqërisë

- Administratori i shoqërisë është **Z. GAZMIR PORJA**, i datëlindjes 19.11.1972, lindur në qytetin Burrelit, dhe banues në Burrel, shtetas Shqiptar, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtës i leter njoftimit me nr. J21119031A.

Specimeni i nënshkrimit



Neni 14

Kompetencat e Administratorit

- 14.1 Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të veprojë si më poshtë:
- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asamblëja e përgjithshme;
 - b) përfaqësoj shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblësë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryen regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) raporton përpara asamblësë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 14.2 Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblënë e Përgjithshme, në rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
 - shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
- 14.3 Nëse asamblëja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 14.4 Asamblëja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me $\frac{3}{4}$ evotave të zotëruesve të kuotave të shoqërisë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- 14.5 Administratori ka të drejtë që në çdo kohë të japë dorëheqjen dhe në këtë moment mbledhet Asamblëja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë për emërimin e administratorit të ri, i cili emërohet me $\frac{3}{4}$ e votave të zotëruesve të kuotave të shoqërisë.



Neni 15

Përgjegjësia e Administratorit

- 15.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 15.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakëve /ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 15.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", administratori detyrohet:
- të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 15.4 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 15.5 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata, apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
- 15.6 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:
- u kthen ortakëve kontributet;
 - u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - jep kredi.

KREU IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

16. Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

- 17.1 Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqërise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 17.2 Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

- 18.1 Shperndarja ose prishja e shoqërise mund të behet ne cdo kohe :
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
 - d) me vendim të gjykatës;
- 18.2 Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".
- 18.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 18.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket me vendim asambleje
- 18.5 Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

- 19.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

- 20.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 20.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

- 21.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Autorizohet Themeluesit dhe njekohesisht Administratori i shoqërisë është **Z. GAZMIR PORJA**, i datëlindjes 19.11.1972 , lindur nëqetytetin Burrelit, dhe banues në Burrel, shtetas Shqiptar, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtës i leter njoftimit me nr. J21119031A që të kryejë dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet e nevojshme për regjistrimin e këtij statuti dhe regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

ORTAKËT
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"P&B VISION" SH.P.K.

MIRELA BRAHASANI



GAZMIR PORJA

